

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

### **QUELLIMI**

- Ne keto specifikime jepet zhvillimi i punimeve dhe kerkesat teknike per zbatimin e projekteve, te hartuara sipas kerkeses dhe standartit shqiptar te rrugeve.
- Te gjitha kerkesat teknike te percaktuar ne keto specifikime jane te detyrueshme per kontraktorin e punimeve.
- Projektet permabajne te gjitha te dhenat e nevojshme per zbatimin e punimeve, bazuar ne matje te sakta te kryera ne terren.
- Per çdo mos perputhje te te dhenave te projekteve me gjendjen ne terren, te behet azhornimi i tyre nga zbatuesi i punimeve, dhe ne konsultim me mbikqyresin e punimeve dhe projektuesin, te behen ndryshimet perkatese, te cilat do te aprovojen nga punedhenesi.
- Keto specifikime perfshijne te gjitha punimet per projektet e zbatimit te paraqitura.

### **ZHVILLIMI I PUNIMEVE**

- Percaktimi i rradhes se zhvillimit te punimeve (per çdo rreshqitje), eshte bere per zbatimin e menjehershem te te gjithe projektit, ne kushte optimale, qe te kemi koston me te ulet, sipas vleresimeve te percaktuara ne preventivat perkates. Per çdo ndryshim te bere nga keto percaktime eshte i nevojshem bashkepunimi me konsulentin.

### **TOPOGRAFIA**

- Para fillimit te punimeve behet azhornimi i pote i projektit me gjendjen ne terren. Evidentohen te gjitha ndryshimet e mundshme dhe i paraqiten ato inxhinierit (mbikqyresit te punimeve), i cili i pasqyron dhe i aprovon tek projektuesi dhe investitori.
- Hedha e objektit ne terren do te behet sipas rilevimit topografik te kryer ne terren, i cili mbeshtetet ne pikave fiksese te vendosura me kunja hekuri ne pozicionin e paraqitur ne planimetrine e projektit. Identifikimi i tyre do te behet ne baze te numrave te Stacioneve dhe pikave fiksese te shkruara me boje. Leximi i projektit do te behet ne baze planimetrisë, profilin gjatesor dhe te numrave te sektioneve.
- Aksi i vijes se projektit eshte dhene me koordinata lokale, tre dimensionale.
- Duke qene se piketat jane ne pozicionin ku do te kryhen punimet eshte e nevojshme qe para fillimit te punimeve, te behet spostimi i tyre nga topografe te specializuar.

- Para fillimit te punimeve eshte e domosdoshme te behet shpronesimi i truallit qe ze rruga sipas projektit, te dhene ne planimetrite dhe tabelat perkatese te shpronesimeve. Shpronesimi do te kryhet nga punedhenesi.

## **RRUGA**

### **PUNIMET E GERMIMIT**

- Punimet e germimit do te behen sipas profilave terthor te projektit.
- Mbasi eshte percaktuar nga matjet topografike kufiri i siperi i skarpates se germimit, behet modinimi sipas pjerresise se skarpates qe eshte percaktuar ne profilin terthor. Per te pasur konfiguracion me te sakte, behet shpeshtimi i pikave.
- Germimet per formimin e trupit te rruges fillojne nga lart poshte, sipas skarpates. Kur lartesia e germimit kalon 3 m germimi behet me shkallezime.
- Kur ne zonen e skarpates qe germohet ndodhen objekte te forta qe prishin pamjen e rruges ato hiqen dhe zevendesohen me material te forte te dale nga germimi.
- Punimet e germimit do te kryhen me makineri te pershtatshme qe ne çdo rast te ngjishet struktura e skarpateve dhe bazamentit. Rregullimi i skarpatave do te behet me krahe ose makineri te pershtatshme.
- Dherat e dala nga germimi nuk do te perdoren ne asnje rast per mbushje te trupit te rruges. Ato do te largohen me makineri dhe do te hidhen ne nje vend te pershtatshem. Nje pjese e dherave (te shkrifet) do te veçohet per t'u perdorur per veshjen e skarpatave te mbushjes.
- Ne qofte se gjate germimit bazamenti ose skarpatat rezultojne te papershtatshem, germimi do te kryhet deri ne gjetjen e bazamentit te pershtatshem. Vleresimi i dherave do te behet nga mbikqyresi i punimeve i cili do te beje ndryshimet perkatese ne projekt.
- Per te vertetuar pershtatshmerine e bazamentit sipas kerkesave te projektit, eshte e nevojshme kryerja e provave ne laborator te certifikuar. Provat jane te detyrueshme te behen ne çdo rast kur kemi ndryshime te perberjes gjeologjike te bazamentit, me kerkese te mbikqyresit.
- Kerkesat e provave dhe kufijt e lejueshem jepen ne kapitullin e provave.
- Gjate germimit do te respektohen te gjitha kushtet teknike te zbatimit te punimeve dhe sigurimi teknik.
- Germimi i kasonetes do te behet pasi jane bere germimet deri ne nivelin e saj. Gjate germimit te saj do te behet ngjeshja dhe trajtimi i bazamentit, siç jepet ne kapitull te veçante te ketyre specifikimeve (2.3.3.).

## **MBUSHJET**

- Punimet e mbushjeve do te behen sipas profilit gjatesor dhe profilave terthor te projektit.
- Ne fillim percaktohet kufiri i poshtem i skarpates se mbushjes dhe pastaj behet modinimi sipas pjerresise se skarpates qe eshte peraktuar ne profilat terthore. Per te saktesar konfiguracionin, veçanerisht ne kthesa, behet shpeshtimi i piketave.
- Para fillimit te mbushjeve behet shkallezimi i skarpatave te terenit kur pjerresia e tyre kalon 7 %. Shkallezimi do te behet ne funksion te formacionit qe perben skarpaten e terenit por jo me shume se 60 cm vertikalish dhe jo me pak se 120 cm horizontalisht.
- Kur ne skarpaten e etrenit ka vegjetacion ose bime, ne çdo rast, te behet pastrimi i tyre, shkulja e rrenjeve dhe heqja e humusit.
- Kur ne pjesen qe do te kryhet mbushja ka dhera te papershatshem, dhera te hedhur dhe mbeturina, detyrimisht ato duhet te hiqen.
- Para fillimit te mbushjes, behet ngjeshja e skarpates ose bazamentit ekzistues, duke e lageshtuar ate ne funksion te formacionit te tokes, stines dhe lageshtise natyrale. Ne pjeset e shkallezuara, ngjeshja do te behet me makineri te pershatashme.
- Ne zonat ku mbushja bie mbi kanale ekzistues, detyrimisht te behet pastrimi i tyre nga llumi dhe germimi do te behet deri ne gjetjen e bazamentit te pershatashem, i cili duhet te ngjishet.
- Mbushjet do te behen me shtresa nga 20 cm dhe do te ngjishen me mjete te pershatashme, siç jepet ne kapitullin e shtresave.
- Mbushjet jane parashikuar te behen me çakull mbeturine, zhavorr lumi natyral ose material tjeter shkembor te pershatashem, me trashesi 20 - 30 cm. Materiali duhet te plotesoje te gjitha kerkesat e standardeve shteterore ne fuqi.
- Modulli i shkallezimit te materjalit qe do te perdoret per mbushjet duhet te jete i pershatashem per te dhene treguesit e meposhtem:
  - Indeksi max. i plasticitetit  $IP \leq 10$
  - CBR minimale 30 %
  - Densiteti i shtreses se ngjeshur 95 % te vleres se proktorit te modifikuar.
  - Per arritjen e treguesve te mesiperme eshte e domosdoshme qe ngjeshja te behet me rulo me peshe 8 - 10 ton, me 6 - 8 kalime vajtje - ardhje ne nje vend duke filluar nga anet ne drejtim te aksit te rruges. Gjate ngjeshjes eshte e nevojshme te behet sperkatja me uje ne masen e nevojshme per te patur nje lageshti optimale te materialit 6 - 8 %.
  - Permbajtja e argjiles dhe materjaleve organike nuk duhet te jete mbi 10 %.

### **KASONETA**

- Punimet per germimin e kasonetes do te fillojne menjehere pas perfundimit te germimit, sipas percaktimeve te bera ne projekt.

- Permasat e kasonetes ne gjeresi dhe thellesi jane percaktuar ne profilat terthor per çdo pikete dhe profilat terthor tip.
- Me gjithe percaktimet e projektit, gjate hapjes se kasonetes te behet verifikimi i shtresave ekzistuese dhe te behen ndryshimet perkatese, kur eshte e nevojshme, te cilat do te aprovojen nga mbikqyresi.
- Pjeset e asfaltit qe nuk mbeshteten ne shtresat ekzistuese te regullta, do te priten. Ne zonen e kontaktit te shtresave ekzistuese me kasoneten e re, te behet pastrimi nga dherat apo çdo material tjeter i papershatshem.
- Piketimi i kufirit te kasonetes behet pas vendosjes se aksit te rruges dhe rregullimeve te nevojshme. Piketat ngulen ne çdo 10 m minimum dhe ngjitur me keto hapen gropat te cilat tregojne tabanin e govates.
- Germimi i kasonetes behet me mjete te pershtateshme, per keto lloj punimesh, qe aprovojen nga mbikqyresi. Kujdes i veçante duhet te tregohet qe gjate germimit te mos prishet struktura e dherave qe perbejne bazamentin.
- Gjate germimit te kasonetes te kihet parasysh largimi i ujraleve siperfaqesor dhe nentokesor, per ruajtjen e struktures se bazamentit nga lageshtia e tepert.
- Germimi do te realizohet me rripa terthor me gjeresi 0.5 – 1.0 m ne çdo 20 m gjatesi, deri ne kuoten e projektit. Mbas perfundimit te ketyre rripave behet germimi ne drejtimin gjatesor te kasonetes.
- Ne qofte se gjate hapjes se kasonetes del bazament i papershatshem ose dhera te hedhur, njoftohet mbikqyresi i punimeve dhe behen ndryshimet perkatese.
- Dherat e papershatshem do te hiqen dhe do te zevendesohen me materialin e shtreses baze, duke e vendosur ate me shtresa 20 cm, te cilat ngjeshen.
- Per te vertetuar pershtatshmerine e bazamentit sipas kerkesave te projektit (pika 2.3.3.14), eshte e nevojshme kryerja e provave ne laborator te certifikuar dhe te aprovar nga konsulenti. Provat jane te detyrueshme te kryhen me kerkese te mbikqyresit, ne çdo rast kur kemi ndryshim te perberjes gjeologjike te bazamentit nga ai i dhene ne kete projekt.
- Pas germimit kasoneta ngjishet me rulo 8 - 10 ton me 4 – 8 kalime vajtje - ardhje ne nje vend. Ngjeshja fillon nga anet ne drejtim te aksit te rruges. Ne vendet ku nuk eshte e mundur te behet ngjeshja me rul, ajo mund te realizohet me çdo mjet tjeter te pershtatshem te aprovar nga mbikqyresi (si tokmak mekanik ose dore).
- Te gjitha uljet qe mund te ndodhin gjate ngjeshjes, duhet te plotesohen me po ate material qe ka projekt, per shtresen baze (çakull rifuto ose zhavor).
- Gjate ngjeshjes eshte e nevojshme te behet lageshtimi me uje i dherave te bazamentit per te pasur nje lageshti optimale 15 - 25 %.
- Mbas ngjeshjes bazamenti duhet te plotesoje keto tregues fiziko - mekanik.

- Densiteti mbi 1.90 gr/cm<sup>3</sup>
- Treguesi i CBR ≥ 6 %.
- Keta tregues do te vleresohen nga provat e kampioneve qe do te beje kontraktori dhe mbikqyresi i punimeve.
- Per gjendjen e kasonetes, para fillimit te shtresave, behet akt - dorezimi i saj.

### **SHTRESAT RRUGORE**

### **SHTRESAT E ÇAKULLIT TE MINAVE**

- Shtresat rrugore jane percaktuar ne profilat terthor tip, per çdo segment rruge. Çdo devijim nga projekti do te behet me miratimin nga mbikqyresi i punimeve dhe projektuesit. Trashesia e shtreses eshte dhene mesatare. Ne kete shtrese do te jepet pjeseria terthore, zgjerimi ne kthesa, profilimi i trupit te rruges simbas kuotave te projektit dhe mbushja e gropave te demtuara qe do te skarifikohen me pare.
- Shtrimi i do te behet pasi te jete bere skarifikimi i dherave e materjaleve te papershtatshem dhe nivelimi i shtresave ekzistuese. Skarifikimi i shtresave ekzistuese do te behet deri ne nivelin e shtresave ekzistuese te pa demtuara, te cilat do te percaktohen ne vend nga mbikqyresi i punimeve, simbas percaktimese te dhena ne projekt dhe keto specifikime.
- Hedha dhe perhapja e materjalit do te behet me makineri ose krahe, pasi te merret aprovimi i mbikqyresit per gjendjen e shtreses se hedhur me pare. Shmangjet e lejuara ne trashesi, pas ngjeshjes, jane; + 5 cm dhe – 2 cm.
- Shtrimi i materjalit do te behet me breza terthor me gjeresi  $0.5 \div 1.0$  m per çdo 20 m, te cilat do te kontrollohen ne kuote pas perfundimit te tyre dhe pas kesaj mbushet pjesa tjeter. Gjate shtrimit te jepet pjeseria terthore e rruges simbas kuotave te profilave terhore te projektit.
- Materiali i ngjeshur ne veper duhet te plotesoje kerkesat e meposhteme:
- Indeksi i plasticitetit  $IP \leq 10$ .
- CBR minimale 30 %
- Densiteti minimal i matur ne shtresat e ngjeshura dhe te thata duhet te jete 95 % e vleres Proktor i modifikuar.
- Shtresa e çakullit te minave ose zhavorit eshte parashikuar te behen me çakull natyral te nxjere nga karierat e gurit me shperthime minash ose material tjeter guror ose lumor, qe ploteson kerkesat e meposhtme:
- Materiali guror duhet te kete fortesine  $\geq 800$  kg/km<sup>2</sup>.
- Marka e thermimit, nga prova Losanxhelos LA  $\leq 30$  %.

- Permbajtja e argjiles duhet te jete me pak se 8 % dhe e mbeturinave bimore me pak se 5 %.
- Dimensioni maksimal i kokrizave nuk duhet te kaloje 2/3 e trashesise se shtreses.
- Granulometria duhet te jete e vazhduar me modul shkallezimi sipas tabeles me poshte:

Dimensioni i sites ne mm	Perqindja e kalimit sipas peshes (%)
100	100
75	80 - 100
40	60 - 85
25	50 - 70
10	40 - 55
5	30 - 50
2	20 - 35
0.4	10 - 20
0.075	7 - 15

- Per arritjen e treguesve te mesiperme eshte e nevojshme te behet ngjeshja me rul me peshe  $10 \div 14$  ton duke bere 8 kalime ne nje vend. Gjate ngjeshjes eshte e nevojshme te behet sperkatja me uje per te arritur lageshtine optimale, te percaktuar ne laborator (rekomandohet  $6 \div 10$  %).
- Ne pjeset e seksionit te rruges qe nuk futet ruli i madh ( $10 \div 14$  ton) ngjeshja do te behet me rul vibrues  $6 \div 8$  ton duke bere minimum 12 kalime ne nje vend.
- Ngjeshja do te behet duke filluar nga anet ne drejtim te mesit te rruges. Cdo kalim i mevonshem duhet te shkele gjurmen e mepareshme minimum 25 cm.
- Mbas ngjeshjes behet plotesimi me material te imet ne pjeset ku ka perqendrim te materialit te trashe.
- Ne qofte se gjate ngjeshjes konstatohen vende me deformime si rezultat i materjalit jo te mire, hiqet kjo pjese e shtreses dhe zevendesohet me materjal te pershatshem.
- 

#### **SHTRESAT E STABILIZANTIT**

- Shtresa e stabilizantit eshte percaktuar ne profilat terthor tip, per cdo segment rruge.
- Stabilizanti eshte parashikuar te prodhohet me material guorre te thyer ose zhavor lumi te thyer, te fraksionuar qe plotesojne kerkesat e meposhteme:
  - Fortesia e gureve perberes  $\geq 800$  kg/cm<sup>2</sup>.

- Marka e thermimit nga prova Losanxhelos, LA  $\leq$  30 %.
- Permbajtja e argjiles deri ne 5 % dhe materjaleve organik deri ne 3 %.

Moduli i shkallezimit te fraksioneve do te jete sipas tabeles me poshte:

Dimensioni i sites ne mm	Kalimi ne site ne %	Mbetja ne site ne %
71	100	0
40	100 - 65	0 - 35
25	75 - 35	25 - 65
10	70 - 30	30 - 70
5	55 - 23	45 - 77
2	40 - 15	60 - 85
0.4	25 - 8	75 - 92
00.75	15 - 2	85 - 98

Pranohet luhatje  $\pm$  3 %

- Materiali i ngjeshur ne veper duhet te plotesoje kerkesat e me poshteme:

- Indeksi i plasticitetit IP  $\leq$  6
- CBR minimale 80 %
- Densiteti minimal i matur i shtreses se ngjeshur dhe te thatë duhet te jete 98 % e vleres Proktor i modifikuar.
- Shtrimi i materialit do te behet ne te gjithe gjeresine e rruges me makineri (ose krahe), pasi te jene bere me pare breza terthore me gjatesi 0.5 – 1.0 m per çdo 20 – 30 m, te cilat kontrollohen ne kuote pas perfundimit te tyre dhe pas kesaj mbushet pjesa tjeter.
- Shmangjet e lejuara te siperfaqes se perfunduar te shtreses do te jene brenda kufijve + 25 mm dhe – 15 mm, nga kuota e projektit.
- Per arritjen e treguesve te ngjeshjes, sipas pikes 2.4.3.3. eshte e nevojshme te behet ngjeshja me rul vibrues me peshe 10 - 12 ton duke bere 12 kalime ne nje vend. Gjate ngjeshjes eshte e nevojshme te behet sperkatje me uje per te arritur lageshtine optimale te ngjeshjes te percaktuar me pare ne laborator.
- Ngjeshja do te behet duke filluar nga anet ne drejtim te mesit te rruges. Çdo kalim i mevonshem duhet te shkele gjurmen e meparshme 25 cm. Mbas ngjeshjes behet plotesimi me material te imet ne pjeset ku ka perqendrim te materialit te trashe.
- Ngjeshja quhet e perfunduar kur nje kokerr çakulli e hedhur mbi mbulese thyhet nga rrota e rulit dhe nuk futet ne shtresen e stabilizantit.

- Levizja e trafikut, ne shtresen e perfunduar duhet te behet i alternuar, me qellim qe te shkelet e gjithe siperfaqja, duke vendosur pengesa te levizeshme ne rruge (ne forme zig – zag) dhe duke vendosur kufizim shpejtesie deri ne 20 km/ore.

### **SHTRESAT ASFALTIKE**

- Shtresa e **binderit** me trashesi 6 cm eshte parashikuar te behet me materjale gurore te thyer, qe plotesojne kerkesat e meposhteme:
- Materiali gurore i thyer duhet te kete fortesine  $700 - 900 \text{ kg/cm}^2$  dhe marke thermimi nga prova Losanxhelos  $\text{LA} \leq 20\%$
- Moduli i shkallezimit te fraksioneve (granulometria ) do te jete si me poshte:

Dimensioni i sites ne mm	Kalimi ne site ne %	Mbetja ne site ne %
25	100	0
15	100 – 65	0 - 35
10	80 - 50	20 - 50
5	60 - 30	40 - 70
2	45 - 20	55 - 80
0.4	25 - 7	75 - 93
0.18	15 - 5	85 - 95
0.075	8 - 4	92 - 96

Pranohet luhatje  $\pm 2\%$

- Para shtrimit te binderit behet pastrimi i shtreses se stabilizantit dhe pastaj behet sperkatje me bitum ne masen  $0.5 \text{ Kg/m}^2$ .
- Ngjeshja e shtreses do te behet me rul me peshe  $10 - 12 \text{ ton me } 8 - 10 \text{ kalime vajte – ardhje ne te njetin vend.}$
- Shtresa konsumuese e **asfalto – betonit** me trashesi 4 cm eshte parashikuar te behet me materjale gurore te thyer, qe plotesojne kerkesat e meposhtme:
- Materiali gurore i thyer duhet te kete fortesine  $700 - 900 \text{ kg/cm}^2$  dhe marke thermimi nga prova Losanxhelos  $\text{LA} \leq 15\%$ .

Moduli i shkallezimit te fraksioneve (granulometria) do te jete si me poshte.

Dimensioni i sites ne mm	Kalimi ne site ne %	Mbetja ne site ne %
0.075	10 - 5	90 - 95
0.18	15 - 7	85 - 93
0.4	20 - 10	80 - 90
2	38 - 25	62 - 75
5	55 - 40	45 - 60
10	90 - 70	10 - 30
15	10 - 90	0 - 10

Pranohet luhatje  $\pm 2\%$

- Para shtrimit te asfalto-betonit behet pastrimi dhe niveli i shtreses se binderit Pastaj behet sperkatje me bitum ne masen  $0.5 \text{ Kg/m}^2$
- Ngjeshja e shtreses do te behet me rul me peshe 8 - 10 ton me 6 - 8 kalime vajtje – ardhje ne te njetin vend.

#### **KARAKTERISTIKAT FIZIKO - MEKANIKE TE MATERIALEVE ASFALTIKE**

MATERIALI I SHTRESES	GRANUL O - METRIA	BITU MI %	STABILITE TI MARSHALL (75 goditje) Kg	RIGJIDIT ETI MARSHA LL	BOSHLLEQ ET MARSHALL %	DENSITE TI NE VEPER (Densiteti Marshall) %
ASFALTO BETON	Tabela	4.5÷6	$\geq 1000$	$> 300$	3÷6	$\geq 97\%$
BINDER	Tabela	4÷5.5	$\geq 900$	$> 300$	3÷7	$\geq 98\%$

- Bitumi qe do te perdoret do te jete i markes 60 - 80 sipas standartit shqiptar STASH 21-60
- Per punimet e shtresave asfaltike do te zbatohet STASH 566 – 87 dhe rezultatet e provave laboratoriike.

#### **NDERTIMI I BANKINAVE**

- Ne projekt bankinat jane parashikuar te ndertohen me shtresat e vijes se kalimit, pa shtresat asfaltike, te cilat jane zevendesuar me stabilizant.
- Bankinat do te ndertohen njekohesisht me shtresat e rruges.
- Ngjeshja e bankinave behet njekohesisht me shtresat e rruges. Kujdes i veçante duhet te tregohet kur ngjishet pjesa afer skarpates se kanalit anesor ose mbushjes. Ngjeshja eshte mire te behet me rul te lehte  $6 \div 8$  ton me  $4 \div 6$  kalime.
- Shtresa e fundit e bankines do te realizohet deri ne nivelin e shtreses se asfaltit dhe do te rulohet njeheresh me te. Gjate ngjeshjes behet plotesimi me material te imet dhe sperkatja me uje.
- Kerkesat e materjaleve me te cilat ndertohen shtresat ne bankinat, jane te njejtë me ato te shtresave te rruges.

### **KANALET ANESORE**

- Per terheqjen e ujrate te shpatit dhe te trupit te rruges, ne pjese te veçanta eshte parashikuar ndertimi i kanaleve anesore.
- Kanalet do te vishen me beton sipas detajeve te projektit.
- Kanalet do te jene tre tipe sipas projektit.
- Kanalet kane forme trapezoidale, duke respektuar thellesine sipas projektit.
- Hapja e kanaleve do te behet me krahe ose makineri dhe dhei do te hidhet ne anen e poshtme te trupit te rruges, ne vende te pershtatshme. Dherat e dala nga kanalet ne asnje rast nuk do te hidhen ne trupin e rruges.

### **VEPRAT E ARTIT**

- Ne kete projekt jane parashikuar te ndertohen mure prites drenazhus, mure me beton, kuneta dhe bordura betoni, mure mbajtes e prites me gabiona, tombino Ø 80 cm, zgjerime te tombinove ekzistuese, kontraforte me gure, zgjerime te urave ekzistuese, kanale betoni, kuneta, etj. per te cilat jane dhene projektet perkatese tip dhe te veçante.
- Vendosja e veprave te artit ne objekt do te behet simbas percaktimave te dhena ne projekt. Kur kemi mosperputhje, mbikqyresi ne bashkepunim me projektuesin te beje korigjimet e nevojshme, pa cenuar ne asnje rast funksionin dhe qendrushmerine e vepres.
- Ne veprat e artit ekzistuese, qe jane ne gjendje te mire, jane bere zgjerimet e tyre ne pershtatje me profilat terthor dhe gjendjen teknike e funksionale te tyre.
- Permasat e veprave te kullimit jane percaktuar per te perballuar prurjet e llogaritura sipas studimit hidrologjik me sigurine 2 % per tombinot rrethore dhe urat e vogela.

- Thellesia dhe permusat e themeleve jane vodosur ne baze te kushteve gjeologjike te terrenit te paraqitur ne studimin gjeologo-inxhinerik, bashkengjitur ketij projekti.
- Vendodhja e çdo vepre arti eshte percaktuar ne perputhje me seksionet e projektit. Ne projekt eshte dhene lidhja e distancave dhe akseve te objekteve qe do te ndertohen, lidhur me aksin e projektuar te rruges.
- Per tombinot rrethore jane dhene projekte tip. Ndertimi i tyre do te behet sipas te dhenave qe jepen ne tabelen perkatese te ketij projekti.
- Per ndertimin e mureve mbajtes e prites me beton, thellesia e vendosjes se tyre eshte parashikuar simbas studimit gjeologo - inxhinerik. Percaktimi i sakte dhe perfundimtar i thellesise se vendosjes se tyre, do te behet me aprovim te mbikqyresit gjate germimit per hapjen e themeleve dhe verifikimit te pershtatshmerise se bazamentit.
- Per thellesine e vendosjen se mureve ne zonat rreshqite, eshte e nevojshme te percaktohet nga gjeologu i kantjerit thellesia e formacionit qe nuk rreshqet ose formacioni baze. Ne rastet kur ka dyshime per vleresimin e formacionit, te behen provat laboratorike perkatese dhe te krahasohen ato me rezultatet e studimit gjeologjik te dhene ne projekt.

### **Kerkesa te Projektit**

Projektet e veprave te artit jane hartuar ne perputhje me kushtet teknike te projektimit shqiptar ne fuqi, per ngarkese te levizeshme N - 18, T - 80.

- Tombinot rrethore jane llogaritur per mbushje minimale 0,5 m dhe maksimale deri 4 m.
- Ngarkesat sizmike jane llogaritur per intensitet te goditjeve 8 balle, ne perputhje me kodin dhe harten sizmike te Shqiperise, ne baze te analizave spektrale. Ne llogaritje jane marre parasysh te gjitha kushtet e bazamentit dhe mbushjes ne veper.
- Llogaritia e bazamentit eshte bere me metoden e sforcimeve te lejuara per kombinimin me te pafavorshem te ngarkesave vepruese.
- Sforcimet e lejuara (rezistenca kushtore) e nevojshme eshte parashikuar te jetë; nen tabanin e tombinove rrethore  $[\sigma] \geq 1.5 \text{ kg/cm}^2$ , nen tabanin e mureve prites e mbajtes prej betoni  $[\sigma] \geq 2.0 \text{ kg/cm}^2$ , nen tabanin e mureve prej gabioni  $[\sigma] \geq 2.0 \text{ kg/cm}^2$ . Ne qofte se gjate hapjes se themeleve nuk rezulton bazamenti i pershtatshem, zbatuesi ne bashkepunim me mbikqyresin dhe gjeologun, te marre te gjitha masat per permiresimin e tij, ose te germohet deri ne gjetjen e tabanit te pershtatshem.
- Muret mbajtes dhe prites jane llogaritur per ngarkese te lejuar ne taban  $[\sigma] \geq 2 \text{ kg/cm}^2$ . Mbushja mbrapa tyre do te behet me zhavorr ose material shkembor me kend te ferkimit te brendshem  $\phi \geq 35^\circ$ . Ne muret do te lihen vrimat e kullimit ne forme shahu çdo  $2 \text{ m}^2$ .

Rreshti i pare do te jete 15 cm mbi nivelin e kunetes ose kanalit te betonit per muret prites dhe ne nivelin e tokes natyrale per muret mbajtes.

- Prodhimi dhe vendosja ne veper i betoneve per strukturat do te behet sipas kushteve teknike te zbatimit ne fuqi. Materialet perberes do te jene ne perputhje me Standartet Shtetore.
- Ne llogaritjen e strukturave, ngarkesat vepruese llogariteze marrin parasysh keto kerkesa:
  - Pesha volumore e betonit  $\gamma_b = 2.5 \text{ t/m}^3$
  - Pesha volumore e tokes  $\gamma_t = 1.8 - 1.9 \text{ t/m}^3$
  - Kendi i ferkimit te brendshem te mbushjes  $\phi \geq 35^\circ$ .
  - Mbingarkesa mbi mbushjen  $q_m = 2 \text{ t/m}^2$
  - Pesha e shtresave  $q_{sh} = 0.3 \text{ t/m}^2$
  - Koeficienti  $E_b/E_a = 10$
  - Kohezioni mur - taban  $C = 0.4 \geq 0.5 \text{ kg/cm}^2$

### **Kerkesa te Zbatimit**

#### **MURET**

- Germimet per ndertimin e veprave te artit mund te kryhen me makineri ose me krahe. Eshte e detyrueshme qe gjate germimit te ruhet struktura natyrale e tokes ne tabanin e themelit.
- Ne rastin kur gjate hapjes se themelit rezulton bazamenti i papershtatshem, me aprovinim e inxhinierit, germimi do te vazhdoje deri ne tabanin e pershtatshem.
- Gjate hapjes se themeleve te ruhen skrapatet e germimit nga rrezimet dhe demtimet e mjeteve te germimit. Per kete te merren masa preventive, sipas stines dhe formacionit te tokes, per puntelimin e faqeve me armature druri.
- Distanca e eskavatorit nga buza e themelit do te jete minimum 2.5 m. Ne çdo rast, para vendosjes se eskavatorit, te verifikohet qendrushmeria e skrapatave. Germimi duhet te kryhet me breza me trashesi nen 1 m.
- Ne qofte se gjate germimeve kemi prani te ujrave nentokesor eshte e domosdoshme heqja e tyre, per te ruajtur strukturen e bazamentit dhe skrapatat.
- Te gjitha mbushjet, per arsyte te shmangieve apo papershtatshmerise se bazamentit, duhet te ngjishen. Çdo pjese me materiale te buta (te hedhur), ose ndertim ekzistues prej betoni, guri apo çdo material tjeter ne bazament, duhet te hiqet dhe te zevendesohet me zhavorr ose material tjeter te pershtatshem.

- Prishjet e strukturave ekzistuese prej mur guri, betoni, e b/arre, duhet te behen me paisje te pershtatshme. Mund te perdoret lende plasese ne mase te vogel vetem per pjeset mbi bazament, me aprovin e inxhinierit te punimeve.
- I gjithe materiali (dheu) i dale nga germimi nuk do te perdoret ne asnje rast per mbushje mbrapa strukturave b/arre dhe mureve.
- Per te vertetuar pershtatshmerine e bazamentit ne veprat e artit, sipas kerkesave te projektit, eshte e nevojshme kryerja e provave nga laborator i certifikuar dhe te aprovojen nga inxhinieri. Provat jane te detyrueshme te kryhen ne cdo rast kur kemi ndryshim te perberjes gjeologjike te bazamentit, me kerkesa te inxhinierit.
- Punimet e germimit, shtresa e zhavorrit, shtresa e betonit, strukturat e betonit dhe b/armese, h/izolimet dhe mbushjet duhet te behen ne perputhje me standartet ne fuqi dhe kushtet teknike te zbatimit. Gjithashtu do te kryhen provat e bazamentit dhe materialeve te ndertimit.
- Te gjitha punimet dhe provat duhet te aprovojen detyrimisht nga inxhinieri i punimeve.

### **TOMBINOT**

- Per rrafshimin e bazamentit dhe permiresimin e struktura se tokes, ne tombinot, vendoset shtresa e zhavorrit, simbas permasave te projektit. Shtresa e zhavorrit vendoset ne te gjithe gjeresine e bazamentit te hapur.
- Shtresa e zhavorrit mund te jete me material lumor ose material guore apo burime te tjera te aprovuara nga mbikqyresi.
- Hedha dhe perhapja e zhavorrit do te behet me krahe mbasi te merret aprovimi i mbikqyresit per bazamentin. Shmangjet e lejuara ne trashesi te shtreses jane : + 5 cm dhe - 2 cm.
- Ngjeshja e zhavorit te bazamentit eshte e detyrueshme per te arritur densitetin prej 90 %. Ajo do te behet me mjete te pershtatshme te aprovuara nga mbikqyresi.
- Dimensioni maksimal i materialit perberes nuk do te kaloje 50 mm. Materiali perberes i shtreses duhet te perputhet me kerkesat qe jepen ne kapitullin e shtresave te rruges.
- Kur trashesia e shtreses kalon 20 cm, per shkaqe te ndryshme te aprovuara nga mbikqyresi, ngjeshja do te behet me 2 ose me shume shtresa. Per te perfituar densitetin specifik te kerkuar ne te tere shtresen, eshte i nevojshem perdonimi i ujit per ta sjelle ate me permbajtje optimale, ± 2%. Atje ku uji eshte i teper duhet ta thajme ose ta heqim ate me mjete te pershtatshme.

- Per sigurimin e mbeshtetjes sa me te mire dhe nivelimin e siperfaqes ku do te vendosen tubat e parafabrikuara beton arme, vendoset nje shtrese betoni me trashesi simbas projektit.
- Shtresa e betonit ndertohet ne kushte optimale te shtreses se zhavorrit. Para hedhjes se betonit te behet korrigimi i nevojshem i shtreses se zhavorrit te hedhur me pare.
- Prodhimi i betonit te shtreses eshte i detyrueshem te behet me cimento portland antisulfate. Materialet perberes te granular mund te jene prej zhavorri humor ose guri te thyer ne perputhje me standartet shteteror ne fuqi.
- Permasat, sasia, cilesia dhe provat qe duhet te kryhen jepen ne kapitullin e provave. Aprovimi i tyre duhet te behet nga mbikqyresi i punimeve.
- Betoni mund te pergetitet ne veper ose poligone prodhimi. Transportimi dhe hedhja e tij ne veper do te behet ne perputhje me K.T.Z.
- Tubat beton arme do te prodhohen dhe vendoset ne perputhje me standartin shteteror ne fuqi (STASH 2503 - 87) dhe projektet tip bashkengjitur.
- Pas vendosjes se parafabrikateve, vendoset kallesi ne te dy anet, hidhet betoni sipas trashesise te percaktuar ne projekt, duke i dhene kurbezim ne pjesen e siperme. Pas 10 ditesh behet mbushja me zhavorr ose materjal tjeter shkembor, me shtresa nga 20 cm duke respektuar te gjitha kushtet si ne shtresen e zhavorrit te specifikuar me pare.

#### **MURET PRITES**

- Muret prites do te zbatohen sipas vizatimeve te projektit dhe percaktimeve te dhena ne to.
- Paragrafet 2.5.42 deri 2.5.46 jane te detyrueshme per tu zbatuar dhe ne muret prites drenazhus.
- Muret prites drenazhus jane parashikuar te sherbejne si drenazh gjatesor (ne pjesen nentokesore, nen nivelin e shtresave te rruges) dhe per mbajtjen e skarpatave te siperme (ne pjesen mbi nivelin e shtresave te rruges). Ata sherbejne kryesisht per terheqjen e ujerave nentokesor dhe largimin e tyre ne anen e poshteme te rruges, nepermjet veprave te kullimit ose drenazheve terthore.
- Pjesa drenazhuse nentokesore do te sherbeje njekohesisht si themel per mbeshtetjen e murit te betonit, qe ndertohet mbi nivelin e shtresave dhe sherben per mbajtjen e skarpatave te siperme dhe kunetes.
- Niveli i tabanit ku do te vendosen muret prites drenazhus duhet te jete i tille qe te siguroje rrjedhjen e ujerave nentokesor. Ne asnjë rast nuk do te lejohet qe ujerat nentokesore te qendrojnë ne bazament.
- Muret prites drenazhus jane parashikuar te vendoset ne bazament te qendrushem te perbere nga formacion qe nuk rreshqet. Ne rastet kur formacioni i pershtatshem nuk del

ne thellesine e percaktuar ne projekt, te germohet deri ne gjetjen e formacionit te pershtatshem, duke siguruar njekohesisht rrjedhjen e ujerave qe grumbullon drenazhi.

- Formacioni i pershtatshem, qe do te sherbeje si bazament sipas studimit gjeologo – inxhinjerik bashkengjitur projektit, jane perkatesisht shtresat Nr. 3 dhe Nr. 4.
- Thellesia e vendosjes se themeleve do te jete minimum 30 cm ne formacionet e percaktuara me siper. Kjo thellesi do te jete ne pjesen me te ulet te shtreses qe do te sherbeje si bazament (ne anen e poshteme).
- Thellesia e germint e parashikuar ne projekt te verifikohet dhe vleresohet, gjate germimit, nga mbikqyresi dhe gjeologu. Kur kemi mosperputhje te formacionit gjeologjik te percaktuar ne profilat terthor te behet ndryshimi perkates ne projekt.
- Germimet do te kryhen duke respektuar drejtimin e aksit dhe kuotat me shmangie qe nuk duhet te kaloje :
  - shmangie e aksit gjatesor 20 cm, per 20 m.
  - shmangie ne kuote 5 cm, per 10 m.
- Para vendosjes se gjeotekstilit te behet pastrimi i themelit te hapur nga dherat e ndryshme dhe kontrolli i bazamentit e skrapatave.
- Gjate vendosjes se gjeotekstilit te percaktohen vendet e lidhjeve gjatesore, qe do te jene ne funksion te gjatesise se copies prodhuar nga fabrika. Shkelja e gjeotekstilit duhet te jete minimum 30 cm. Gjeotekstili duhet te plotesoje kushtet e percaktuara ne projekt, per peshen ne nje meter katerore. Gjate vendosjes se gjeotekstilit duhet te behet mire puthitja e tij me faqet anesore te kanalit te germuar.
- Materjali shkembor, qe do te perdoret per mbushjen e mureve prites drenazhus, duhet te plotesoje kushte te njejtë me ato te mbushjeve me materjal shkembor te nxjere nga karierat e pershtateshme. Ne pjesen e poshteme materjali duhet te jete me dimensione me te medha (deri 20 cm) dhe ne pjesen e siperme dimensionet do te vijne duke u zvogeluar.
- Materjali duhet te plotesoje kushtet e nje granulometrie te rrjedheshme, per te dhene vleren e Proktorit te modifikuar 90 %. Kjo do te arrihet duke bere ngjeshjen e materjalit me shtresa deri ne 30 cm. Ngjeshja do te behet me rula vibrus me peshe mbi 4 ton, ose me mjete te tjera te pershtateshme. Pjesa e mbushjes prane siperfaqes se tokes do te ngjeshet me rula vibrus me peshe mbi 16 ton, me  $8 \div 10$  kalime ne nje vend. Gjate hedhes se materjalit mbushes dhe ngjeshjes se tij duhet te kemi kujdes ruajtjen e gjeotekstilit nga demtimi dhe vertikalitetin e faqeve anesore te tij.
- Ana e siperme e drenazhit mbushet me materjal shkembor me te trashe (deri 30 cm), per te sherbyer si drenazh mbrojtes dhe njekohesisht per te ulur shtytjen e dherave te skrapatave te siperme. Ky materjal nuk do te ngjishet, por do te qendroje i shkrifet per te

luajtur sa me mire rolin e drenazhit. Gjithashtu granulometria e keti materjali shkembor duhet te jete e rrjedheshme.

- Muri prites me beton ndertohet ne te njeften menyre si muret e tjere prites te specifikuar me siper. Gjate vendosjes se kallepeve te percaktohen vendet e fugave te bymimit gjatesor qe do te jene ne çdo 4 + 6 m, ne funksion te bazamentit ku mbeshtetet muri prites drenazhus. Ndarja e fugave do te behet me lende druri me trashesi minimale 1 cm, ose materjal tjeter te pershtatshem qe do te aprovohet nga mbikqyresi.
- Minimum pas 10 ditesh behet mbushja plotesuese mbrapa murit te betonit me materjal shkembor deri ne nivelin e percaktuar ne projektet tip. Materjali qe do te perdoret per mbushje do te kete kendin e ferkimit te brendeshem minimum 35 ° dhe vendosja e tij do te behet simbas percaktimeve te projektit.
- Ne pjesen e siperme te mbushjes vendoset nje shtrese argjile e ngjeshur e cila formon me murin e betonit dhe skarpaten e siperme nje kanal gjatesor. Ky kanal do te sherbeje si kanal prites i ujerave qe vijne nga skrapata e siperme, per ti percjelle ato per ne veprat e kullimit (tombinot).
- Ne anen e rruges, perbri murit te betonit, ndertohen kuneta anesore prej betoni, sipas permasave te percaktuara ne projekt.
- Drenazhet terthor do te ndertohen ne te njeften menyre si muret prites drenazhus, sipas pozicioneve dhe permasave te projektit.

## **SINJALITIKA**

### **SINJALITIKA HORIZONTALE**

- Materialet e produara ne forme industriale apo artizanale, perpara se te perdoren ne kantier duhet qe nje moster t'i paraqitet mbikqyresit dhe pas miratimit te tij keto materiale dhe kryesisht boja e vijezimit do te mund te perdoret per vijezimin e rruges.
- Boja e vijezimit reflektuese duhet te jete e paraperzier, d.m.th sferat e xhamit duhet te jene perzier gjate fabrikimit, te jene homogjene dhe nuk duhet te kete papasterti. Sferat e xhamit pas tharjes se bojes duhet te japin nje ndricim te tille ne menyre qe dritat e automjeteve te thyhen nga keto te fundit.
- Ngjyrat: te jete e bardhe ose e verdhe ne perputhje me ate te kerkuarin. Ngjyra duhet te ruhet ne kohe dhe kerkohet perpara fazes se kolaudimit.
- Pigmenti per bojen e bardhe dhe pigmenti ngjyrues do te perbehet nga bioksidi titanit. Per ngjyren e verdhe pigmenti do te perbehet nga kromati i plumbit.
- Pesha specifike dhe stabiliteti i bojes se hedhur nuk duhet te absorboje vajra apo substanca te tjera duke formuar njolla te ndryshme dhe sidomos gjate muajve te veres

nuk duhet te futet dhe te perzihet me bitumin. Pesha specifike duhet te jete me shume se 1.5 kg per liter ne temperaturen 25°C.

- Koha e tharjes nuk duhet te kaloje 30 minutat ne kushte temperature 30°C, ne kushte lageshtire relative 65 % per spesore rreth 200 mikron. Pas kalimit te kesaj kohe boja nuk duhet te hiqet nga gomat e makinave.
- Viskoziteti duhet te jete 70 – 90 njesi krebs.
- Mbetja e pa avullueshme duhet te jete nga 65 – 75 % ne peshe.
- Sferat e xhamit duhet te jene transparente dhe rreth 90 % duhet te kene forme sferike dhe jo ovale. Treguesi i reflektimit duhet te jete me i madh se 1.5.
- Koeficenti i ashpersise sipas metodes se matur nga TRL angleze nuk duhet te jete me pak se 60 % e ashpersise se rruges se palyer.
- Karakteristikat Fiziko - Kimike te bojes duhet te jene:
  - Masa volumore 1.7 kg/L
  - Mbetje jo te avullueshme 75 % ne peshe
  - Viskoziteti 89/90 KU
  - Permbajtja e pigmentit ne boje 35 %
  - Permbajtja e bioksidi titanit ne boje 16 % ne peshe
  - Koha e tharjes (hapja e rruges trafikut) 30 min
  - Fuqia mbuluese 1.3 m<sup>2</sup>/kg
  - Rreshqitshmeria S.R.T. 44
  - Permbajtja e sferave ne boje 20 % e peshes
  - Granulometria e sferave duhet te jete:
    - Kalimi ne site ASTM Nr. 70 : 100 %
    - Kalimi ne site ASTM Nr. 140 : 22 %
    - Kalimi ne site ASTM Nr. 230 : 0.84 %
- Perberja e solventit duhet te jete nga Benzine Toluene Xilene max 45 %. Perzierja e diluentit me bojen duhet te jete me teper se 4 %.
- Siperfaqet qe do te lyhen duhet te pastrohen mire ne menyre qe mos te kete asnje papasteri ne rruge. Eshte e ndaluar qe te elemenojnen njollat e vajit me ane te solventeve. Eleminimi i pluhurit duhet te behet me ane te aspiratoreve mekanike ose mjeteve te ngjashme duke mbajtur nje fare distance nga zona ku po vijezohet. Aplikimi i vijezimit duhet te behet ne siperfaqe te thata dhe me mjete sa me te vogla ne menyre qe te mos pengoje levizjen e trafikut. Boja nuk duhet te jete me teper se 2.1 m<sup>2</sup> ne 1 kg ne rastet kur i bhet per here te dyte ose kur ka vijezim ekzistues dhe jo me teper se 1.5 m<sup>2</sup> ne 1 kg boje kur vijezimi eshte i ri. Keto normativa duhet te kontrollohen nga supervizori

gjate punimeve te sinjalitikes me ane te kalibrave te posaçem. Heqja e sinjalitikes horizontale ekzistuese me ane te makinerive abrasive duhet te behet me kujdes per te mos demtuar siperfaqen e rruges.

### **SINJALITIKA VERTIKALE**

- Furnizimin dhe vendosja e shenjave rrugore do te behet ne perputhje me specifikimet e meposhtme, pozicionin dhe dimensionet e treguara ne vizatim si dhe sugjerimet e bera nga mbikqyresi i punimeve. Te gjitha shenjat duhet te bazohen ne ngjyre, permase, forme, simbol dhe shkrim me Kodin Rrugor dhe Rregulloren e Kodit Rrugor te Republikes se Shqiperise.
- Materiali i prodhimit te shenjave rrugore mund te jete flete çeliku e galvanizuar ose flete alumini.
- Bishti mbajtes se tabeles duhet te jete tub çeliku i galvanizuar dhe me gjatesi nga 3.5 m ÷ 5Bishti

i tabeles vendoset ne rruges sipas menyes se percaktuar ne vizatim duke u betonuar ne nje

- bazament betoni te M - 200.
- Tabelat e rrezikut, te perparese, ndalimit etj, te jene te permasave "Normale" te percaktuara ne Kodin Rrugor. Per tabelat trekendeshe, permasa virtuale e tij te jete 90 cm, ndersa per tabelat rrethore diametri i tij te jete  $\phi$  60 cm.
- Tabelat "treguese jashte qytetese" tip shigjete, duhet te jene 40 cm te larta dhe te gjata ne varesi nga shikimi, por jo me pak se 1.5 m.
- Madhesia e shkronjave ne tabelat informuese tip shigjete te jene sipas alfabetit "Normal" te parashikuara ne Kodin Rrugor dhe lartesia e shkronjave te jete 14 cm. Largesia e pozicionit te tabeles se rrezikut nga pika te jete 70 deri 100 metra.
- Menyra e vendosjes se tabeles ne mbajtesen e saj te jete siç eshte tregar ne figure duke respektuar dimensionet.
- Tabelat shevro te perdoren ne kthesa te ngushta me rreze me te ngushte se 30 m dhe ne pozicion 90 grade me aksin e rruges.
- Delineatoret e kthesave (shevron) vendosen ne kthesa sipas vizatimit bashkengjitur ne largesine 8 m per kthesat me rreze nga 30 deri 50 m, 12 m per kthesat me rreze nga 50 deri 100 m.
- Pervijuesit anesor vendosen ne kufijte e jashtem te bankinave jo me pak se 50 cm nga ana e jashtme e rruges, lartesia e tij nga rruga duhet te jete 70 deri 110 cm. Ne krahun e djathte te levizjes duhet te shfaqet nje element reflektues me ngjyre te kuqe, kurse ne krahun e majte duhet te shfaqet nje element rreflektues i bardhe. Siperfaqja minimale e nje elementi duhet te jete 60 cm<sup>2</sup>.

- Ne pranine e barierave metalike, parapeteve apo pengesave te tjera, pervajesit anesore te zevendesohen me elemente reflektues te kapura ne objekt me te njejtat veçori qe pershkruam me lart.
- Tabelat duhet te kene aftesi fotometrike sipas klasit 1 dhe 2 te parashikuar ne Kodin Rrugor.
- Mbrapa tabelas te shenohen: Enti pronar i rruges (DPRr); Marka e firmes prodhuese te sinjalit; Viti i prodhimit dhe numri i lejes se dhene nga Ministria e Transportit. Siperfaqja e shenimeve te mesiperme nuk duhet te kaloje 200 cm katrore.
- Per te gjithe paqartesite kontraktori te bashkepunoje me mbikqyresin dhe projektuesin, per realizimin e pote te sinjalikes gjate zbatimit te punimeve.

### **PROVAT**

- Provat e bazamentit, shtresave, betoneve dhe te gjithe materjaleve te ndertimit qe perfshihen ne specifikimet teknike te keti projekti, jane te detyrushem te behen ne laboratore te certifikuar. Te gjitha kerkesat e percaktuara ne keto specifikime jane te detyrueshme te respektohen nga kontraktori dhe mbikqyresi i punimeve.
- Per te gjitha materialet qe do te perdoren ne veper, eshte e domosdoshme te kryhen provat e testimit te tyre ne laborator dhe pas verifikimit te rezultateve te tyre me kerkesat e ketyre specifikimeve, nga mbikqyresi, te lejohet perdonimi i tyre ne veper.
- Prodhimi i betonit ne poligon ose veper do te behet sipas aprovimit nga inxhinieri i karrierave dhe burimeve te materialeve perberes.
- Betonet do te prodhohen sipas kerkesave te projektit ne perputhje me standartin shqiptar STASH 562-87, 563-87.
- Çimentoja qe do te perdoret per betonet do te jete portland antisulfate ne perputhje te pote me standartin shqiptar STASH 501-87, 503-87. Markat e çimentos do te jene sipas kerkesave te betonit dhe do te percaktohen nga mbikqyresi, pas provave.
- Testimi i çimentos do te behet per çdo 50 tone prodhim te gatshem. Provat duhet te kenaqin te gjitha kerkesat e projektit.
- Rera per betonet duhet te plotesoje kerkesat e standartit shqiptar STASH 538-87. Testimi do te behet per çdo 300 m<sup>3</sup> prodhim dhe me aprovim te mbikqyresit.
- Çakelli dhe zalli qe perdoren si material inert duhet te plotesoje kerkesat e STASH 540-87. Testimi do te behet per çdo 300 m<sup>3</sup> prodhim dhe me aprovim te mbikqyresit.
- Armatura e hekurit eshte me çelik periodik te prodhimit shqiptar STASH 858-87 me marke Ç - 31s ose sipas standartit italian Fe B - 44 K.
- Testimi do te behet ne perputhje me kerkesat e standardeve dhe sipas kerkesave te mbikqyresit.

## **PUNIMET E BETONIT, KALLEPIT DHE ARMATURES SE HEKURIT**

### **Betoni monolit (i prodhuar ne kantier)**

#### **Kerkesa te per gjithshme per betonin**

Ne kete seksion do japim kerkesat e per gjithshme qe aplikohen mbi punimet e betonit monolit. Betonet do te prodhohen sipas kerkesave te projektit ne perputhje me standartin shqiptar STASH 562-87, 563-87.

#### **Relacionet**

Kontraktori duhet te mbaje relacione me shkrim ku perfshihet informacioni i me poshtem:

Data e betonimit te çdo seksioni, marka e betonit, kohezgjatja e hedhjes ne veper te betonit, pozicioni i seksionit ne projekt, numrin e thaseve ose pesha totale e çimentos se perdorur ne seksion.

Temperaturen maksimale dhe minimale ditore.

Llojin e kampionit dhe daten e marrjes, perfshire dhe marken e tij.

Rezultatet e provave te kampioneve te marre.

#### **Materialet**

##### **Perberesit**

Perberesit duhet te jene ne perputhje me specifikimet teknike.

Perberesit nuk duhet te permajne depozitime te materialeve te demshme organike si p.sh. barishte, drunjë ose materiale te ngjashme.

Perberesit qe mund te kene një potencial per reaksione alkaline duhet te vleresojen me kujdes dhe nese ka rrezik potencial per një reaksiون alkalin, inxhinieri duhet te marre një vendim te qarte dhe perfundimtar mbi pershtatshmerine e perberesve.

##### **Çimento**

Çimento duhet te jetë ne perputhje me kushtet e STASH 501-87, 503-87. Markat e çimentos do te jene sipas kerkesave te betonit dhe do te percaktohen nga mbikqyresi, pas provave.

Testimi i çimentos do te behet per çdo 50 tone prodhim te gatshem. Provati duhet te kenaqin te gjitha kerkesat e projektit.

Kontraktori do te pajise çdo ngarkese te çimentos me një kopje te fatureve qe deklaron sasine e dorezuar, emrin e prodhuesit dhe çertifikaten e prodhuesit e cila tregon per çdo ngarkese çimentoje provat dhe analizat e bera ne perputhje me standartet.

##### **Rera**

Rera per betonet duhet te plotesoje kerkesat e standartit shqiptar STASH 538-87. Testimi do te behet per çdo  $300 \text{ m}^3$  prodhim dhe me aprovim te mbikqyresit.

- **Çakelli**

Çakelli dhe zalli qe perdoren si material inert duhet te plotesoje kerkesat e STASH 540-87. Testimi do te behet per çdo 300 m<sup>3</sup> prodhim dhe me aprovim te mbikqyresit.

### Uji

Uji duhet te jete i paster, i lire nga acidet, alkalinet, sheqeri dhe substance te tjera organike. Uji i pijsphem eshte ne per gjithesi i pranueshem per betonin. Pershtatshmeria e ujit do te provohet nga provat e kryera ne nje laborator te aprovuar.

Perberesit shtese nuk duhet te perdoren ne beton pa aprovimin e Inxhinierit i cili mund te kerkonte kryerjen e provave laboratorike perpara se keto te perdoren.

### Depozitimi i materialeve

#### Çimento

Çimento, e cila depozitohet ne kantier duhet te jete e mbuluar qe te sigurohet nje mbrojtje optimale nga lageshtia dhe nga faktore te tjere, te cilet mund te perspejtojne prishjen e çimentos.

Kur çimento eshte e ambalazhuar me thase 50 kg, theset do te vendosen ne rregull siper njeri-tjetrit, por jo me shume se 12 thase dhe do te vendosen ne menyre te tille qe te perdoren sipas radhes se mberritjes ne kantier.

Depozitimi i çimentos ne sillosa ose konteniera te ngjashem duhet te parashikoje qe çimento qe merret per tu perdorur te matet me peshe dhe jo me volum.

Çimento nuk duhet perdorur kur eshte mbajtur ne magazine mbi 6 javë.

#### Agregatet

Perberesit me permase nominale te ndryshme duhet te magazinohen te ndara ne menyre qe te shmanget perzierja ose ndotja me materiale te huaja.

Zonat e magazinimit duhet te kene nje baze betoni dhe nje kufizim i cili do sherbeje per mosperhapjen e perberesve. Zona duhet te jete e drenazhuar mire per te parandaluar ndotjen e perberesve nga te gjitha anet.

### Kapaciteti i magazinave

Kapaciteti i parashikuar i magazinave dhe sasia e materialit te magazinuar si p.sh. çimento, aggregate ose uje duhet te jete i mjaftueshem per te siguruar vazhdueshmerine e kontrates dhe mosnderprerjen e saj per shkak te mungeses se materialeve.

#### Klasifikimi i perzierjes se betonit

Termat e me poshtem do te perdoren per te pershkruar marken e betonit te kerkuar:

#### Betoni per gellime ndihmese:

Perziera e betonit do te perbehet nga çimento e zakonshme Portland dhe perberes me permase nominale 40 mm.

Raporti i perzierjes se perberesve me çimenton nuk duhet te jete mbi 8:1 ne volum ose 10:1 ne peshe. Ne rastin e ambalazheve te medha nuk ka nevoje per llogaritje. Betoni duhet te perzihet me makineri ose me dore duke arritur një konsistencë dhe ngjyre uniforme perpara perdorimit. Sasia e ujit e perdorur nuk duhet te kaloje sasine e nevojshme per prodhimin e një betoni me perpunueshmeri te mjaftueshme gjate hedhjes dhe ngjeshjes ne vendet e kerkuara. Ngjeshja e betonit mund te kryhet me dore ose me vibrim mekanik.

#### **Perzierjet e projektuara**

Kur specifikohet një perzierje e projektuar për një strukturë të zakonshme betoni, kontraktori ose prodhuesi do të jene pergjegjes per caktimin e raportit të perzierjes per të perfuar rezistençen dhe perpunueshmerinë e kerkuar, por inxhinieri do të jete pergjegjes per specifikimin e sasise minimale të çimentos dhe ndonjë të dhëne tjeter që kerkohet për sigurimin e qendrueshmerise. Marka e betonit të kerkuar do të përshtatzet me fortësinë karakteristike në  $N/mm^2$  me permasesin maksim të perberesit në (mm) të treguar si indeksë si psh. marka 25/20 tregon betonin me fortë karakteristike  $25N/mm^2$ , ndersa agregatet me permasa maksimale 20 mm.

#### **Permbajtja minimale e çimentos**

Per agregatet e dhëne sasia e çimentos duhet të jete e mjaftueshme për të siguruar një perpunueshmeri të mire me një raport uje/çimento të ulet në menyre që betoni të ngjishet teresistë duke perdorur mjetet në dispozicionin tone.

Tabela 7.1.1 na jep permbajtjen minimale të çimentos që kerkohet kur perdorim një permase të veçante të perberesve të betonit me çimento Portland, për të siguruar qendrueshmerinë e pranueshme nën kushtet e pershtatshme të eksplozimit. Reduktimi i permbajtjes minimale të çimentos se dhëne në Tabelen 7.1.1 mund të perdoret vetem atehere kur treshja e perzieresve ka vertetuar që një beton me një raport uje/çimento nuk eshte me i madh se ai që jepet për kushtet e veçanta, mund të prodhohet dhe që ai eshte i vlefshëm për kushtet e perdorimit dhe kompaktesimit.

#### **Kufiri mesatar i fortësisë**

Perzierja e betonit duhet të jete e projektuar që të ketë të pakten permbajtjen minimale të çimentos që kerkohet dhe të kemi rezistence mesatare me të madhe se sa rezistencë karakteristike e kerkuar ose të pakten sa madhesia kufitare.

Ky kufi duhet të merret sa  $2/3$  e rezistencës karakteristike për betone me marke  $10N/mm^2$ , ose  $15 N/mm^2$  për betone me marke 20 ose me të madhe.

#### **Evidencia e pershtatshmerise se raportit të perzierjes se propozuar.**

Evidencia do t'i paraqitet Inxhinierit për çdo marke të betonit duke treguar punueshmerinë e kerkuar, sasine e perberesve për perzierjen e propozuar dhe metodat e prodhimit për të bere të mundur marrjen e një betoni sipas cilesise të kerkuar.

Nese te dhenat e nevojshme te forces nuk jane te arritshme, do te pergatitet treshja perzierese ose, per beton te zakonshem, do te pershtaten raportet e dhena ne tabelen 7.1.3. per prodhimin fillesttar.

Si rrjedhim Kontraktori do te deklaroje çdo ndryshim per burimin e materialeve apo te permbajtjes se çimentos e cila rezulton me një diferenca me te madhe se  $20 \text{ kg/m}^3$  nga permbajtja e deklarimit te fundit.

#### **Fortesa e betonit**

Kontraktori do te jetë perjegjes per projektimin e perzieres se betonit dhe per raportet e materialeve perberes, te nevojshme per prodhimin e betonit, i cili ploteson kerkesat e specifikuara ne tabelen 7.1.4 per çdo marke betoni.



Permaja mininale e çimentos qe kerkohet per betone me çimento Portland per te siguruar qendrueshmeri nen ndikimin e kushteve te ekspozimit.

**Tabela 7.1.1**

Ekspozimi	Beton i armuar				Beton i paranderur				Beton i theshte			
	Permasa max. e perberesve(mm)				Permasa max e perberesve (mm)				Permasa max. e perberesve (mm)			
	40	20	14	10	40	20	14	10	40	20	14	10
	Kg/m <sup>3</sup>	Kg/m <sup>3</sup>	Kg/m <sup>3</sup>	Kg/m <sup>3</sup>	Kg/m <sup>3</sup>	Kg/m <sup>3</sup>	Kg/m <sup>3</sup>	Kg/m <sup>3</sup>	Kg/m <sup>3</sup>	Kg/m <sup>3</sup>	Kg/m <sup>3</sup>	Kg/m <sup>3</sup>
I butë: p.sh. Teresht i mbrojtur nga moti ose kushtet agresive, me perjashtim te periudhes se shkurtër se ekspozimit ne kushtet normale te motit gjate kohës se ndertimit	220	250	270	290	300	300	300	300	200	220	250	270

<b>Mesatar:</b> p.sh. i mbrojtur nga shirat e forte dhe kunder ngrices ndersa ngopet me uje. Betoni nentoke dhe betoni vazhdimisht nen uje.	260	290	320	340	300	300	320	340	220	250	250	280	300
<b>Iashper:</b> psh. Ekspozuar ndaj ujit te detit, gjoit, shirave te rrrembyer, alternimit lagje-tharje dhe ngrirjes ndersa laget. Subjekt i kondensimit te madh ose agjenteve korrozive.	320	360	390	410	320	360	390	410	270	310	330	360	360

**Tabela 7.1.2**

Kur rapporti i lire maksimal uje/çimento mund te kontrollohet rigorozisht vlerat e Tabeles 7.1.1 mund te reduktohen ne:

Eksposizimi	Betoni i armuar			Betoni i paranderur			Betoni i thjeshte			Raporti i lire max uje-çimento		
	Permase max e perberesve (mm)			Permase max e perberesve (mm)			Permase max e perberesve (mm)					
	40 Kg/m <sup>3</sup>	20 Kg/m <sup>3</sup>	14 Kg/m <sup>3</sup>	10 Kg/m <sup>3</sup>	40 Kg/m <sup>3</sup>	20 Kg/m <sup>3</sup>	14 Kg/m <sup>3</sup>	10 Kg/m <sup>3</sup>	40 Kg/m <sup>3</sup>	20 Kg/m <sup>3</sup>	14 Kg/m <sup>3</sup>	10 Kg/m <sup>3</sup>
I bute	200	230	250	260	0.65	300	300	300	0.65	180	200	220
Mesatar	240	260	290	310	0.55	300	300	300	0.65	200	230	250
I ashper	290	330	350	370	0.45	300	330	350	0.45	240	280	300

**Perzierjet per beton te zakonshem**

Pesha e cimentos dhe te te gjithe perberesve te thate (ne kg) per te prodhuar afersisht 1 (nje) meter kub beton te ngjeshur bashke me perqindjet ne peshe te perberesit te imet ne teresine e perberesve te thate.

**Tabela 7.1.3**

Marka e betonit	Permase max. e perberesve (mm)	40		20		14		10	
Punueshmeria		Mesata r	Larte	Mesat .	Larte	Mesat.	Larte	Mesat.	Larte
	Limitet e renies (mm)	50-100	100 - 150	25-75	76-125	10-50	50-100	10-25	25-50
7	Çimento (Kg)	180	200	210	230	-	-	-	-
	Perberesit totale (Kg)	1950	1850	1900	1800	-	-	-	-
	Perberesit e imet (%)	30-45	30-45	35-50	35-50	-	-	-	-
10	Çimento (Kg)	210	230	240	260	-	-	-	-
	Perberesit totale (Kg)	1900	1850	1850	1800	-	-	-	-
	Perberesit e imet (%)	30-45	30-45	35-50	35-50	-	-	-	-
15	Çimento (Kg)	250	270	290	310	-	-	-	-
	Perberesit totale (Kg)	1850	1800	1800	1750	-	-	-	-
	Perberesit e imet (%)	30-45	30-45	35-50	35-50				

20	Çimento (Kg)	300		320	350	340	380	360	410
	Perberesit totale (Kg)	1850	320	1800	1750	1750	1700	1750	1650
	Rera:		1750						
	Zona 1 (%)	35		40	45	45	50	50	55
	Zona 2 (%)	30	40	35	40	40	45	45	50
	Zona 3 (%)	30	35	30	35	35	40	40	45
			30						
25	Çimento (Kg)	340	360	360	390	380	420	400	450
	Perberesit totale (Kg)	1800	1750	1750	1700	1700	1650	1750	1600
	Rera:								
	Zona 1 (%)	35	40	40	45	45	50	50	55
	Zona 2 (%)	30	35	35	40	40	45	45	50
	Zona 3 (%)	30	30	30	35	35	40	40	45
30	Çimento (Kg)	370	390	400	430	430	470	460	510
	Perberesit totale (Kg)	1750	1700	1700	1650	1700	1600	1650	1550
	Rera:								
	Zona 1 (%)	35	40	40	45	45	50	50	55
	Zona 2 (%)	30	35	35	40	40	45	45	50
	Zona 3 (%)	30	30	30	35	30	40	40	45

### Klasa e betonit

Tabela

Klasa e betonit	Forca karakteristike shkaterruese per 28 dite (N/mm <sup>2</sup> )	Permasa max. e perberesve
15/20 15/40	15	20 40
20/14 20/20 20/40	20	14 20 40
25/14 25/20 25/40	25	14 20 40
30/14 30/20 30/40	30	14 20 40
40/14 40/20 40/40	40	14 20 40
50/14 50/20 50/40	50	14 20 40
60/14 60/20 60/40	60	14 20 40

Klasa e betonit tregohet nga forca e shkatterimit te kubit ne 28 dite ne N/mm<sup>2</sup> dhe permases max. te preberesve te trashe ne perzierje p.sh. Klasa 30/40 e betonit do te thote qe betoni perballon nje force shkaterruese te kubit me 30 N/mm<sup>2</sup> ne 28 dite dhe permasa max. te perberesve te trashe prej 40 mm.

Forca shkateruese e betonit qe do perdoret ne kete kontrate do te jete ne perputhje me klasen e dhene ne tabelen 7.1.4.

Permbajtja e çimentos per çdo klase te betonit nuk do te tejkaloje madhesine e betonit Uljet e betonit duhet te jene brenda kufirit te specifikuar ne tabelen 7.1.5.

Me perjashtim te rasteve kur drejtohen nga Inxhinieri, raporti uje/çimento i perzierjes per çdo klase te betonit nuk duhet te jete me i vogel se 1.90 edhe sikur kerkesat e forces se betonit do te arrihen me nje raport uje/çimento me te ulet. Betoni me nje raport uje/çimento minimal te papercaktuar do te shenohet me nje simbol "W" p.sh. Klasa W 30/40 e betonit do te thote qe raporti uje/çimento i ketij betoni do te jete me i vogel se 1.90.

**Vlerat e Uljeve**

Nr.	Tipi i Konstruksionit	Ulja ne (mm)	
		max	min
1	Betone per dysheme dhe elemete parafabrikate	75	50
2	Beton i paranderur	75	25
3	Themele te armuar te mureve dhe pila monolite (me perjashtim te pilotave te derdhur ne te thatë).	125	50
4	Soleta, trare, kollona dhe mure te armuar	125	50
5	Bazamente betoni, kasetat dhe muret nenstruktura e mureve	100	25

- Ne rastet kur perdoren frekuencia te larta vibrimi, vlerat e me siperme do te reduktohen me 1/3. Betoni duhet te kete punueshmerine e pershtatshme, pa perdonur sasira te teperta uji, ne menyre qe te ngjishet mire neper qoshet e kallepit dhe perreth armatures, kanaleve pa patur nje ndarje te materialit.

#### Perzierja e pershkruar.

Inxhinieri do te jete perqejges per percaktimin e raportit se çdo materiali perberes se perzierjes se betonit. Kontraktori duhet te siguroje ne kohe ne kantier materialet specifike qe do perdoren per betonin ne sasine e porositur nga Inxhinieri.

Kontraktori do te jete perqejges per furnizimin e materialeve perberes per betonin dhe ai duhet qe te pakten dy muaj perpara se te filloje punimet e betonit ne kantier, te pajise Inxhinierin me mostra

te çdo materiali perberes per t'i bere provat laboratorike. Nese materialet perputhen me specifikimet, kontraktori duhet te siguroje me pas mostra te permasave te treguara nga Inxhinieri per percaktimin e raporteve te perzierjes se çdo klase te betonit. Inxhinieri do te specifikoje klasat e betonit per perzierjet e pershkruara me perjashtim te dy klasave nominale qe do specifikohen ketu e me poshte.

Per çdo klase do te kemi specifikimet e meposhtme:

- Vleresimi i formes minimale shtypese ne N/mm<sup>2</sup> per 28 dite.
- Permasa max. nominale e perberesit te trashe ne mm, dhe raporti i tij ne perzierge.
- Raportin e perberesit te imet ne perzierge
- Tipi dhe raporti i çimentos ne perzierge.
- Raporti uje/çimento
- Uljet ne mm

Inxhinieri ka te drejten te ndryshoje sipas proçesit te punes, raportet e perberesve te betonit. Perzierjet e specifikuara per t'u perdorur jane paraqitur ne projektet ose ne volumet e punes, ose kur urdherohen nga Inxhinieri jepen ne Tab. 7.1.6.

**Tabela**

**Perzierjet nominale**

Perzierge	Çimento (kg)	Perberesit (m <sup>3</sup> )	Sasia max. e ujit (litra)	Forca ngjeshese e vleresuar per 28 dite (N/mm <sup>2</sup> )
1 : 4 : 8	50	0.40	50	7
1 : 3 : 6	50	0.30	42	15
1 : 2 : 4	50	0.20	30	20

**Shenim:**

Permasa max e perberesit te trashe dhene ne mm per nje perzierge te kerkuar do te shkruhet si shtojce e klases psh. klasa 1 : 4 : 8 /40. Raporti i perberesit te imet me ate te trashe mund te rregullohet per te prodhuar nje perzierge te punueshme.

Sasia totale e ujit perfshin dhe ate qe permbajne perberesit.

Konsistenza dhe punueshmeria do te jetë siç eshte treguar ne tabelen 7.1.5.

**Natyra dhe burimi i çdo materiali.**

---

Para fillimit te çdo punimi me beton ne kantier Kotraktori duhet te paraqese tek Inxhinieri, per aprovim mostra te materialeve perberes te betonit dhe nje formular ku paraqiten raportet e perzierjes qe ai propozon te perdore per çdo klase betoni.

Mostrat duhet te shoqerohen me nje evidence qe do te plotesohet me kerkesat per tipet e ndryshme te materialeve te specifikuara. Formulari i raporteve te perzierjes do te shoqerohet me evidencen ku vertetohet qe betoni i prodhuar nga materialet dhe ne raportet e propozuara do te kete karakteristikat e specifikuara. Ose:

Te dhenat ekzistuese perkatese si prove te arrijes ne vlera te kenaqshme te fortessise mesatare te lejuar dhe n.q.s. kerkohet, perpunueshmeria dhe reporti uje/ çimento, ose :

Te dhena te plota mbi testimet ose provat e perberjes, ose:

Per beton te zakonshem nje deklarate qe per prodhimin fillestar mund te perdoren proporcionet e pershtatshme te perzierjes qe jepen ne tabelen 7.1.2.

Sasite e propozuara per çdo perberes per meter kub te betonit te plete te njeshur jepen ne tabelen 7.1.3 te dhene me siper.

#### **Provat e perzierjes**

Kotraktori eshte perjegjes per te nxjerre provat per çdo marke te betonit qe do perdoret ne punime. Do te behen tre pakot te veçante duke perdorur material te ngjashem qe te jetë tipik me furnizimin e propozuar dhe mundesisht ne te njejtat kushte prodhimi. Nese rrethanat e bejne kete te pa mundur, pakot mund te perzihen ne laborator, me kusht qe te specifikohet nga Inxhinieri. Punueshmeria e seciles nga provat e pakove, perfundon me berjen e tre kubave prej seciles pako qe te mund te kryhet testi per 28 dite. Tre kube te tjere do te behen prej seciles pako me qellim qe te testohet here tjeter nese kerkohet.

Raportet ne peshe te çimentos, ujit dhe perberesit ne secilen perzierje per te arritur rezistencen e duhur do te percaktohen dhe dorezohen Inxhinierit per aprovim. Keto raporte nuk do te ndryshojne gjate punes pa miratimin me shkrim te Inxhinierit.

#### **Furnizimi me beton**

Ky seksion mbulon prodhimin e betonit, perfshire levizjen dhe dorezimin e materialeve, transportin, vendosjen, perpunimin e tij sipas nevojes.

Transportimi dhe vendosja e betonit miks (te perbere) mbulohet nga ky seksion dhe aksesoret e betonit, perfshire karkasat dhe armaturen ne sektionet respektive.

#### **Perzierja e betonit**

Per betonin masiv dhe betonin e shurdhuar mund te perdoren te agregatet e permendura. Sasia e çimentos, sasia e agregatit te imet ose te trashe do te maten ne peshe me perjashtim te rasteve qe bihet dakord me inxhinierin.

Nje pajisje e veçante do te sigurohet per peshimin e çimentos.

Sasia e ujit do te matet ne volum ose peshe. Çdo mase solide perzierese qe duhet te shtohet do te matet me peshe, por lengjet mund te matet me volum ose peshe.

Peshat e pakove te perberesve do te rregullohen qe te lejojne nje permbajtje te lageshtise tipike te perberesve qe do te perdorim.

Tolerancat e aparaturave matede do te jene  $\pm 3\%$  te sasise se çimentos, ujit ose te aggregateve ne total dhe  $\pm 5\%$  te perberesve shtese qe do te perdorim.

Te gjitha pajisjet matede do te ruhen ne kushte pastertie dhe sherbimi te pershtatshem.

Koha e perzierjes nuk duhet te jetë me e vogel se ajo e perdorur gjate prodhimit per vleresimin e performances se perzierjes.

Ne rastin e perzierjes me perpunueshmeri te ulet ose me permbajtje te larte çimentoje, kjo mund te mos siguroje rezistence max. dhe keshillohet te percaktohet nje kohe perzierje e mjaftueshme duke bere krahasimin e rezistences se mostrave te perzierjes me kohe te ndryshme.

#### **Kontrolli i permbaitjes se ujit**

Kontrolli i permbajtjes se ujit ne secilen pako betoni do te rregullohet e tille qe te prodhohet beton me perpunueshmerine e kerkuar nga provat e perzierjes.

#### **Rregullimi i raportit te perzierjes**

Gjate prodhimit, rregullimi i raportit te perzierjes do te behet me miratimin e Inxhinierit, me qellim qe te minimizoje luhatjet e rezistences dhe per te arritur sa me afer kufirit mesatar te rezistences. Te tilla rregullime behen si pjese e kontrollit te prodhimit, por kufijte e specifikuar te permbajtjes minimale te çimentos dhe maksimumi i raportit uje/çimento duhet te ruhet. Ndryshimet ne permbajtjen e çimentos duhet te deklarohen. Rregullime te tilla te raportit te perzierjes nuk do te behen per te arritur ndonje ndryshim te vlerave ekzistuese.

#### **Matja per furnizimin e betonit**

Njesia matede do te jetë metri kub i matur si volum ne fund te vendosjes. Sasite do te llogariten nga dimensionet neto qe jepen ne vizatimet ose ne te dhenat e tjera te inxhinierit.

#### **Vendosja e betonit ne veper**

Ne kete paragraf do te flasim per transportimin dhe hedhjen e betonit pas perqatitjes.

#### **Transporti dhe vendosja**

#### **Transporti**

Betoni i perzier duhet te shkarkohet nga betoniera dhe te transportohet ne vendin ku do te perdoret ne menyre te tille qe te shmanget humbja e perberesve dhe qe perzierja e betonit te kete perpunueshmerine e duhur deri ne momentin e perdorimit.

#### **Hedhja ne veper**

Kontraktori duhet te njoftoj Inxhinierin te pakten 24 ore perpara se sa ai te hedhe betonin ne veper per te bere te mundur qe ai te kryeje inspektimin e tij mbi kalipet dhe hekurin e armimit. Asnjehere nuk duhet te hidhet beton ne veper pa patur aprovimin e Inxhinierit per te bere diçka te

---

tille. Betoni do te hidhet ne veper brenda nje (1) ore pasi ai eshte shkarkuar nga betoniera dhe nuk do te lejohet shtimi i ujit ose materialeve te tjere.

Ne çdo rast qe te jete e mundur, betoni do te hidhet vertikalisht ne veper (kjo per te shmangur ndarjen apo zhvendosjen e pjeseve te fiksimit)

Duhet te shmanget rrjedhja anesore e betonit gjate procesit te hedhjes ose gjate vibrimit te betonit. Betoni nuk duhet te zere shtrese kompakte horizontale me te trashe se 0.5m dhe grumbullimi duhet shmangur.

Kur perdoren goditje per te liruar betonin duhet te merren masa qe te mos shkaktohet shkeputja dhe duhet te perdoren mistri te pershatshme per te siguruuar shkarkimin e betonit.

Betoni nuk duhet te lejohet te bjere lirshem nga nje lartesi me e madhe se 1.5 m.

Betoni nuk duhet hedhur gjate oreve te mbremjes nese nuk jane marre masa per nje ndricim te pershatshem. Per me teper, punetoret nuk do te lejohen te punojne dy turne dhe Kontraktori duhet te siguroje nje turn te ri te fresket per punen qe do kryhet naten.

Betoni nuk duhet te hidhet ne veper nese temperatura e ambjentit eshte me poshte se 7°C. Betoni normalisht hidhet vetem ne te thate. Hedha e betonit ne uje do te kryhet vetem ne raste te vecanta, me aprosimin e Inxhinierit, ne pamundesi per te bere tharjen para hedhjes. Asnjehere betoni nuk do hidhet ne uje te rrjedhsphem.

#### **Pompimi**

Pompimi i betonit do te kryhet vetem pas aprosimit nga ana e Inxhinierit te metodave te propozuara nga Kontraktori. Do te merren dhe mostra nga betoni i pompuar per prova laboratorike ne perfundim te shkarkimit te tubit te pompes.

#### **Ngjeshja (kompaktesimi)**

Betoni do te ngjishet plotesisht me mjete te aprovuara nga Inxhinieri, gjate dhe menjehere pas perfundimit te hedhjes. Do te punohet me kujdes tek kallepet dhe perreth armaturave te montuara, pa i spostuar ato.

Betoni duhet te mos kete boshlleqe dhe plane te dobesuar. Shtresat pasuese te se njejtes lartesi duhet qe te punohen bashkerisht me kujdes.

Depozitimi i betonit ne ndonje pike dhe punimet e tij ne pozicione anesore, qofte me vibrator ose ne menyra te tjera nuk lejohet.

Me aprosimin e Inxhinierit, betoni mund te ngjishet me vibrator. Ne kantier duhet te kete disa vibratore ne gjendje pune si dhe pjese kembimi per to.

Dohen eleminuar ndarjet e shkaktuara nga vibrimi i tepert, pikimet (rrjedhjet e ujit).

Kur jane perdorur vibratore me zhytje duhet te eleminohet sa te jete e mundur kontakti me kallepet dhe sendet e tjera qe mund te kemi vendosur.

#### **Fugat**

### **Te pergjithshme**

Betonimi do te vazhdoje pa nderprerje tek fugat e treguara ne vizatimet e punimeve ose siç eshte miratuar, me perjashtim te ndonje rasti urgjent (si thyerja e impiantit te perzierjes ose kohes se papershtatshme) qe betonimi do te nderpritet, fugat do te realizohen ne vendin e ndalimit ne menyre qe te mos demtoje qendrueshmerine, pamjen dhe funksionin e betonit.

Ne se nuk jepet ne vizatime, pozicioni i sakte i fugave horizontale do te shenohet ne kallepe me ane te shiritave drejtues me qellim qe te sigurojme saktesisht fugen horizontale

### **Pergatitja e siperfaqes se fuges**

Kur betoni te jetë vendosur dhe ndersa eshte akoma i pampiksur, do te hiqet një shtrese e holle e siperfaqes dhe materialet e teperta, pa prishur agregatin, me ane te mjeteve te pershtatshme me uje dhe një furçë te lehte. Kur kjo nuk eshte e mundur siperfaqja do te hiqet pas ngurtesimit te betonit me ane te mjeteve mekanike te pershtatshme per marken e betonit. Siperfaqja e ashpersuar do te lahet me uje.

### **Hedhja e betonit te fresket ne fugat e ndertimit**

Ne rast se betoni i fresket hidhet ne te njejtin dite, ai do te hidhet direkt ne siperfaqen e betonit te vjeter, pergatitur si ne paragafin 7.1.3.2.2.

Kur betoni i fresket do te hidhet një dite me vone se sa betoni i vjeter, atehere perpara se te hidhet betoni i fresket duhet te pergatitet një mase me trashesi rrëth 15 mm i perbere nga çimento, rere te perziera ne te njejtat raporte si te betonit te perdonur.

Masa e betonit te ri do te vendoset menjehere pas lagies me uje te betonit te vjeter.

Betoni i hedhur menjehere mbi një konstruksion lidhes horizontal duhet te permbaje vetem 2/3 e sasise normale te aggregatit te ashper dhe nuk duhet te jetë sasia e pare qe del nga perzieresi.

Kur betoni i vjeter eshte mbi 3 dite i vjeter, ai duhet te laget vazhdimesh per 24 ore, pastaj te hidhet llaçi dhe betoni i ri.

Per siperfaqe vertikale, kur eshte e mundur, pergatitet me kujdes një mase çimento – rere e lengshme ne rapport 1:1 dhe vihet ne siperfaqen ku menjehere pas kesaj do te hidhet betoni i ri.

Per lidhjet e konstrukzionit mund te perdoret me aprovin e inxhinierit rreshire epokside. Siperfaqja e betonit te vjeter duhet pastruar, thare dhe mbrojtur ne perputhje me udhezimet e prodhimit dhe hedhjes se betonit te fresket gjate periudhes se rekomanduar nga prodhuesi.

### **Trajtimi dhe Mbrojtja**

I gjithe betoni do te trajtohet me ane te mjeteve te aprovuara, minimumi per 7 dite. Keto kushte mund te plotesohet duke i lene format (kallepet)ne vend.

### **Kushtet e Pafavorshme te Motit**

#### **Moti i Ftohte**

Betoni nuk do te vendoset gjate renies se temperatures kur temperatura atmosferike bie nen  $7^{\circ}\text{C}$  ose gjate ngritjes se temperatures kur temperatura atmosferike eshte nen  $3^{\circ}\text{C}$ . Betoni i cili

---

eshte demtuar nga ngrirja ose arsyte tje qe do te hiqet dhe do te zevendesohet me beton te fresket.

### **Moti i Nxehte**

Kur temperatura atmosferike eshte mbi  $32^{\circ}\text{C}$ , temperatura e betonit ne momentin e depozitimit, nuk duhet ta kaloje kete temperature. Rezervat e aggregateve dhe te gjitha siperfaqet metalike te kontaktit do te ruhen nga rrezet e diellit ose do te freskohen duke i sperkatur me uje.

### **Tubat**

Asnje tub qe nuk eshte treguar ne vizatimet e punes nuk do te fiksohet ne beton pa marre aprosimativ. Shtresa e betonit qe mbulon tubin duhet te jete te pakten 25 mm.

### **Matjet dhe Pagesat per Vendasjen e Betonit**

Asnje matje e veçante nuk do te behet per vendosjen e betonit. Kompensimi i pote per kerkesat e vendosjes se betonit do te perfshihen ne çmimet per betonin te paraqitura ne Volumet e Punes ne Preventiv qe perfshijne dhe furnizimin me beton.

### **Testimi i betonit**

Ky paragraf do te pershkruaje menyren e testimeve te perzierjeve te betonit te projektuar dhe procedurat ne rast se deshtojne.

### **Te per gjithshme**

Analizat laboratorike do te behen ne perputhje me specifikimet dhe do te aplikohet te gjitha parashikimet e paraqitura aty.

### **Procedurat ne rast deshtimi**

Ne se betoni konsiderohet nga Inxhinieri qe nuk mund te permbushe Specifikimet, Inxhinieri ka te drejten te kerkonte marrjen e ndonje ose te gjitha masat e me poshtme:

Materialet dhe raportet e perzierjes mund te ndryshohen per te perfthuar një rezistence me te madhe.

Provati do te perseriten (ribehen) deri sa berthama e çpuar nga pjesa qe permboj strukturen e betonit te prishur, te tregoj qe fortesa e betonit ploteson kerkesat e forteseve. Koha e per gjithshme e lejuar nuk duhet te kaloje 2 muaj mbas hedhjes se betonit.

Ne qofte se rezultatet e provave ne berthame, tregojne qe, pavaresisht nga periudha kohore shtese e lejuar, betoni nuk permbush kushtet specifike, do te kryhen testet e ngarkeses ne shkalle te gjere.

Ne qofte se testet ne berthame, ose testet e ngarkeses, sipas opinionit te Inxhinierit janë te pamundura per tu kryer, ose ne se një pjesë e struktura qe testohet rrezikon te kaloje testin, Kontraktori duhet qe sipas menyres se shpjeguar nga Inxhinieri te kryej zevendesimin e çdo pjesë te deshtuar apo qe permboj beton qe ka deshtuar, me shpenzimet e veta.

### **Matjet dhe pagesat per testimet**

---

Kosto e gjithe testeve ne perputhje me kete paragraf perfshire edhe furnizimin, pajisjen me kubik betoni duhet te mbulohen nga kontraktori dhe per llogari te tij (kontraktorit) do te jene te gjitha shqetesimet dhe vonesat qe mund te lindin.

Asnje reklamim nuk do te behet per ndonje vonese, ose ndryshim programi shkaktuar nga deshtimi i betonit dhe kontrolli laboratorik i përshtkuar me siper, edhe kur provat kontrollet te betonit te pranohen ose jo.

### **Kallepet dhe betoni i perfunduar**

#### **Perkufizim**

Kallepet do te perfshijne te gjitha format e perkohshme ose te perhershme qe sherbejne per te kryer betonimin bashke me te gjitha pjeset e perkohshme qe sherbejne per mbajtjen e tyre.

#### **Vizatimet dhe ndertimi**

Kallepet do te projektohen dhe te ndertohen ne menyre te tille qe te mos kemi rrjedhje te materialit te betonit gjate procesit te hedhjes ne pozicionin e duhur si dhe gjate ngjeshjes se tij. Pas ngurtesimit betoni duhet te jete ne pozicionet dhe format e kerkuara, dimensionet dhe nivelet e treguara ne projekt.

Kallepet dhe nyjet duhet te jene ne gjendje te perballojne ngarkesen maksimale, presionin e betonit te lengshem, forces se eres dhe gjithe ngarkesave dhe forcave te mbivendosura. Kontraktori do te jete i vetmi perqiegjes per fortessine dhe qendrueshmerine e kallepeve.

Kontraktori duhet te perqatise vizatime dhe llogari per sistemin e kallepeve qe do te perdoren dhe t'ia parashtroje kete Inxhinierit per aprovim para se te filloje ndertimin e tyre.

Nuk do te perdoren tela lidhes, por do te perdoren shufra lidhese. Shufrat lidhese ose pjeset e heqshme do te hiqen pa u demtuar dhe vrimat do te mbushen me llaç-cimento. Asnje nga copat metalike te shufrave lidhese qe ngelin te ngulura nuk duhet te jene me te dala se 40 mm nga siperfaqja e perfunduar e betonit.

Vetem po te tregohet ndryshe ne vizatime, shiritat do te behen (ndertohen) ne anen e kallepeve ne menyre qe zgavra 25x25 mm te mund te qendroje ne gjithe qoshet e dukshme te betonit, pavaresisht se te tilla zgavra jane paraqitur ne vizatim ose jo.

Aty ku shihet e nevojshme per hedhjen e betonit, mund te sigurohen disa hapje te perkohshme qe sherbejne per pastrim ose per hedhjen e betonit.

#### **Pergatitjet per kallepet**

Siperfaqet e kallepeve qe do te jene ne kontakt me betonin duhet te trajtohen per te siguruar nje disarmim te lehte dhe mos ngjitjen e betonit me kallepin.

Veshja me agjente leshues do te behet ne perputhje te plote dhe ne menyre te perpikte me instrukzionet e prodhuesit.

Kallepet me derrase do te lagen lehte me uje pak para betonimit.

Para se te riperdoren, te gjitha kallepet do te riparohen dhe te gjitha siperfaqet qe jane ne kontakt me betonin do te pastrohen me kujdes pa shkaktuar demtime te siperfaqes se kallepeve.

#### **Hegja e kellepeve**

Kallepet nuk duhet te hiqen perpara se betoni te kete arritur fortessine e nevojshme per te mbajtur si peshen e tij edhe ngarkesat qe mund te vendosen mbi te.

Kushti i qendrimit te kallepeve ne vend (pa levizur) pas lidhjes se betonit, quhet i plotesuar ne rast se zbatohet periudha kohore minimale e dhene ne tabelen 7.1.3. me perjashtim kur Kontraktori i provon Inxhinierit se nje periudhe me e shkurter eshte e mjaftueshme per te plotesuar keto kushte.

#### Tabela

Kohezgjatja minimale e mbajtjes se kallepeve, kur kemi perdorur cimento Portland.

Tipi i Kallepit	Temperatura siperfaqsore e betonit	
	16° C	7° C
Kallepet vertikale tek kollonat, muret dhe traret e medhenj	2 dite	3 dite
Kallepe te lehte tek soletat	4 dite	7 dite
Kembaleca (mbeshtetese) tek soletat	11 dite	14 dite
Kallepe te lehte tek traret	8 dite	14 dite
Kembaleca (mbeshtetese) tek traret	15 dite	21 dite

**Shenim:** Kur perdoret cimento me ngrirje te shpejte kjo periudhe mund te shkurtohet, gjithmone ne se lejohet nga Inxhinieri.

Per periudha me kohe te ftohte mund te kemi zgjatjen e kohes se mbajtjes se kallepeve me nga  $\frac{1}{2}$  dite per çdo dite qe kemi nje temperature  $7^{\circ}\text{C}$  deri ne  $2^{\circ}\text{C}$  dhe zgjatjen me nga nje dite per çdo dite qe kemi nje temperature me te vogel se  $2^{\circ}\text{C}$ .

Kallepet do te hiqen me kujdes ne menyre qe te shmangim tronditjen ose demtime te betonit.

#### Siperfaqet e formuara, Klasat e perpunimit dhe punimet riparuese

##### Klasa A, e perpunimit te siperfaqes

Do te perdoret ne siperfaqet e betonit te pa ekspozuara. Parregullsite ne perfundim do te jene jo me te medha se ato te marra nga perdonimi i kallepeve te trashe me siperfaqe te ashper. Perfundimisht synohet te lihet siç eshte, por me pasaktesi aq te vogla te cilat mund te riparohen me metodat e miratuara nga Inxhinieri.

##### Klasa C, e Perpunimit te Siperfaqes

Do te perdoret ne siperfaqet e betonit te ekspozuara.

---

Per kete perpunim do te perdoren kallepe te ndertuara me materiale te cilat sigurojne nje siperfaqe te lemuar te strukture uniforme dhe pamjes se jashtme. Kallepet do te lidhen dhe fiksohen ne menyre qe te mos lihet asnje defekt siperfaqesor mbi strukturen. Kontraktori duhet te rregulloje shume mire ndonje parregullsi ne rezultatin e arritur. Shenjat e fugave do te ndjekin nje skeme te rregullt te aprovuar nga Inxhinieri per t'i pershtatur me pamjen e jashtme te strukturen. Per ndonje trajtim riparues i i siperfaques duhet te merret aprovimi i Inxhinierit dhe te behet direkt pas heqjes se kallepeve. Asnje riparim nuk do te behet perpara kontrollit nga Inxhinieri. Zonat e vogla te zgavrave apo parregullsi te tjera si edhe siperfaqet e izoluara, do te mbushen me llaç i perbere nga çimento dhe rere ne raportin e perdonur ne beton. Per riparimin e zgavrave te thella dhe te medha do te perdoren teknika dhe metoda te veçanta si aplikimi pneumatik i çimentos, çimentim me presion, agjente lidhes epokside etj., te perdonura me aprovimin e Inxhinierit. Te gjitha zonat e riparuara do te mbahen vazhdimesht te lagura per 5 dite. N.q.s. perpunimi i siperfaques se ekspozuar nuk ploteson kerkesat per nje strukture dhe pamje uniforme, Kontraktori do te lemoje me ferkim siperfaqen e ekspozuar te strukture apo pjese te saj, n.q.s. do te kerkohet nga Inxhinieri. Para leimit duhet te kene mbaruar te gjitha riparimet. Siperfaqja do te laget me uje per te pakten 1 ore, lemimi fillestare do te filloje te behet me gure (karbit silici me ashpersi mesatare, duke perdonur nje sasi te vogel llaçi ne siperfaqe. Lemimi do te vazhdoje deri sa te gjitha shenjat e ngelura apo parregullsите jane hequr dhe eshte arritur nje siperfaqe uniforme e strukturen. Lemimi perfundimtar do te behet me gur karbit silici te lemuar dhe me uje. Ky lemid do te vazhdoje derisa e gjithe siperfaqja te jete e lemuar. Pas kesaj siperfaqja do te lahet me furçe per te hequr stukon dhe pluhurin e tepert.

**Shoqeria Zenit&Co Shpk**

**Administrator  
Arqile PERI**